



BULETINI

Tema e numrit: Përmendorja kushtuar viktimave të termetit

Përmbajtja

- Trupat punues të Kuvendit..... 2
- Shërbimet publike të Komunës së Ulqinit..... 3
- Mbledhjet e Kuvendit..... 4
- Aktivitete 6
- Përkujtime 10



Ceremonia e zbulimit të Përmendores së viktimave të termetit të vitit 1979

f. 9 ▲

Fjala e kryetarit të Kuvendit

I nderuari lexues,

Para jush është numri i dytë i Buletinit të Kuvendit të Komunës Ulqinit.

Për shkak të pandemisë së CoVID19, ky Buletin mbulon veprimtarinë e këtij institucioni gjatë vitit 2020 dhe 3 muajve të parë të vitit 2021.

Gjatë këtij viti të pazakontë, Kuvendi i Ulqinit ka pasur më pak aktivitet legjislativ, por veprimtaria e tij ka mbetur e gjallë, siç dëshmojnë edhe artikujt në këtë numër.

Tema e këtij numri është përmendorja kushtuar viktimave të termetit të vitit 1979. Ky objekt u përrua në Ulqin më 14 janar 2021 dhe është vënë në qendër të vëmendjes së këtij numri për arsye se është një vendim model i funksionimit të administratës vendore në një qytet. Kujtojmë: iniciativa për ngritjen e këtij monumenti ka dalë nga qytetarët Mentor Llundj dhe Sami Flamuri. Për ta realizuar këtë, Kuvendi fillimisht ka propozuar Programin e ngritjes së përmendoreve për vitin 2020 dhe për të ka marrë pëlqimin e Qeverisë. Pas kësaj ka filluar hulumtimi për gjetjen e saktë të emrave të viktimave dhe zgjidhjes arkitektonike të përmendores.

Më vonë është miratuar edhe vendimi përkatës dhe brenda afateve të këtij vendimi, ka filluar realizimi i përmendores në bashkëpunim të vazhdueshëm me inicuesit. Ky model nuk është inovacion i joni, por zgjidhje e paraparë në ligj dhe duhet ndjekur më tej për vepra dhe probleme të tjera që e shqetësojnë apo ia përmirësojnë jetën qytetarit.

Pak përpara fillimit të pandemisë, kemi vizituar Kuvendin e Shkodrës të cilin e drejtonte një bijë e Ulqinit. Gjatë këtij takimi dhe gjatë takimit të përbashkët me kryebashkiaken e Shkodrës, u dakorduam për disa fusha veprimi dhe kjo nuk duhet lënë pas dore.

Gjatë pandemisë, Ulqini ka humbur shumë bijë e bija tonat e ndër to edhe një këshilltar të ri të Kuvendit dhe një këshilltar nga mandatet e mëparshme. Po i përmend këtu për të ngritur vetëdijen që nepërmjet këtyre emrave, të kujtojmë emrin e çdo qytetari tjetër që la këtë botë nga CoVID19.

Dr. Ilir Çapuni





I. Trupat punues të Kuvendit

Këshilli për Zgjedhje dhe Emërime

- Sabri Salaj, Kryetar
- Luigj Shkrela, anëtar
- Beqir Sellaj, anëtar
- Jasmina Hasa, anëtare
- Ilir Tafica*, anëtar
- Nevryz Shaptafoviq*, anëtar
- Naser Resulbegoviq, anëtar

Këshilli për Statut dhe Dispozita

- Arjan Lamoviq, Kryetar
- Alim Jahaj*, anëtar
- Florim Pali, anëtar
- Halil Truma*, anëtar
- Nella Milloviq, anëtare
- Arian Murati, anëtar
- Xhevdet Seferi, anëtar
- Nevryz Shaptafoviq*, anëtar
- Naser Resulbegoviq, anëtar

Këshilli për Planifikim dhe Rregullim të Hapësirës, Veprimtari Komunale - Banesore

- Xhavid Hoxhiq, Kryetar
- Marko Shkrela, anëtar
- Agron Mehmedi, anëtar
- Gazmond Kaleziq, anëtar
- Muamer Rashçiç, anëtar
- Ardijan Mavriq, anëtar
- Omer Bajraktari, anëtar
- Naser Resulbegoviq, anëtar
- Nazif Cungu, anëtar

Këshilli për Barazi Gjinore

- Majlinda Duraku, Kryetare
- Aida Lleshi, anëtare
- Xhevdet Seferi, anëtar

- Jasmina Hasa, anëtare
- Nella Milloviq, anëtare
- Omer Bajraktari, anëtar
- Naser Resulbegoviq, anëtar

Forumi për Emërimin e Rrugëve, Shesheve dhe Institucioneve

- Nail Draga, Kryetar
- Luigj Shkrela, anëtar
- Agron Mehmedi, anëtar
- Xhavidet Cakuli, anëtar
- Fejzi Hoxha, anëtar
- Beqir Zati, anëtar
- Safet Beci, anëtar
- Naser Resulbegoviq, anëtar
- Hajredin Kovaçi, anëtar

Forumi për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor

- Abedin Avdiu, Kryetar
- Gani Rexha, anëtar
- Tahir Tahiri, anëtar
- Kabil Jakupoviq, anëtar
- Zenepa Likoviq, anëtare
- Anton Lulgjuraj, anëtar

Këshilltarët të cilët marrin pjesë në kurorëzim

- Ardijan Mavriq, Kryetar
- Majlinda Kurt, anëtare
- Eleonora Shata, anëtare
- Beqir Sellaj, anëtar
- Xhevdet Seferi, anëtar
- Gazmond Kaleziq, anëtar
- Nella Milloviq, anëtare
- Omer Bajraktari, anëtar
- Naser Resulbegoviq, anëtar

Këshilli për Financa, Ekonomi dhe zhvillim

- Haxhi Sulejmani, Kryetar
- Borislav Bashoviq, anëtar
- Arian Murati, anëtar
- Gazmond Kaleziq, anëtar
- Xhavid Hoxhiq, anëtar
- Arjan Lamoviq, anëtar
- Halil Truma*, anëtar
- Omer Bajraktari, anëtar
- Naser Resulbegoviq, anëtar

Këshilli për Veprimtari Shoqërore, Parashtrës dhe Ankesa

- Majlinda Kurt, Kryetare
- Xhelal Dervishi, anëtar
- Aida Lleshi, anëtare
- Xhevdet Seferi, anëtar
- Ilir Tafica*, anëtar
- Gazmond Kaleziq, anëtar
- Muamer Rashçiç, anëtar
- Nevryz Shaptafoviq*, anëtar
- Naser Resulbegoviq, anëtar

Këshilli për Bashkëpunim Ndërkomunal, Ndërkombëtar dhe Bashkëpunim me Diasporën

- Halil Truma*, Kryetar
- Luigj Shkrela, anëtar
- Xhelal Dervishi, anëtar
- Arian Murati, anëtar
- Ilir Tafica*, anëtar
- Majlinda Duraku, anëtare
- Florim Pali, anëtar
- Nevryz Shaptafoviq*, anëtar
- Naser Resulbegoviq, anëtar





**Forumi për Përmirsimin e
Pozitës së Invalidëve dhe
Personave të Hendikepuar**

- Shaban Lleshi, Kryetar
- Mirjeta Gjoni, anëtare
- Majlinda Kurt, anëtare
- Jasmina Hasa, anëtare
- Indira Batriceviq, anëtare
- Skender Elezagiq, anëtar
- Magdalena Gjonoviq, anëtare

*Nevryz Shaptafoviq është zgjedhur anëtar i këshilleve të Kuvendit të Komunës së Ulqinit dhe i është verifikuar mandati në mbledhjen e mbajtur më 14.12.2020, pas dorëheqjes së këshilltarit Ilir Harasani.

*Ilir Tafica është zgjedhur anëtar i këshilleve të Kuvendit të Komunës së Ulqinit dhe i është verifikuar mandati në mbledhjen e mbajtur më 14.12.2020, pas dorëheqjes së këshilltarit Arsim Cuca.

*Halil Truma është zgjedhur anëtar i këshilleve të Kuvendit të Komunës së Ulqinit dhe i është verifikuar mandati në mbledhjen e mbajtur më 14.12.2020, pas ndarjes nga jeta të këshilltarit Dritan Alaj.

*Alim Jahaj është zgjedhur anëtar i këshilleve të Kuvendit të Komunës së Ulqinit dhe i është verifikuar mandati në mbledhjen e mbajtur më 14.12.2020, pas dorëheqjes së këshilltarit Bojan Gjakonoviq.

II. Shërbimet publike të Komunës së Ulqinit

SHPK „Ujësjellësi dhe kanalizimi” Ulqin

Fuad Haxhibeti, Drejtor
Nail Rexha, Kryetar i Bordit
Dritan Pulti, anëtar
Zenel Seloviq, anëtar
Mirsad Grdoçi, anëtar
Isa Kraja, anëtar

SHPK „Veprimtaritë komunale” Ulqin

Skender Kaleziq, Drejtor
Arjeta Kurti- Kryetare e Bordit
Senad Kollari, anëtar
Arbin Çapriqi, anëtar
Nikola Marnikoviq, anëtar
Xhemal Vukoviq, anëtar

SHPK „Për ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit, rritjen dhe gjuetinë e egërsirave ” Ulqin

Ajet Zaga- Drejtor
Tihomir Rakoçeviq, Kryetar i
Bordit
Fuad Lamoja, anëtar
Dritan Rexha, anëtar

NP „Qendra për kulturë”, Ulqin

Musa Hoxhiq – U.D. Drejtor
Dr. Sabina Osmanoviq,
kryetare e Këshillit
Cano Lazoja, anëtar
Lavdim Çausi, anëtar
Lilana Çoviq, anëtare
Aferdita Tejoviq, anëtare
Veneranda Gjonaj, anëtare
Asllan Allaj, anëtar

Agjensioni për ndërtim dhe zhvillim të Ulqinit

Shpëtim Maraj-Drejtor
ekzekutiv

IP „Qendra Ditore për Fëmijë dhe të Rinj me Pengesa dhe Vështirësi në Zhvillim - Sirena”

Bilal Alaj- Drejtor
Ramazan Kurti- Kryetar i
Këshillit
Mehmet Duraku, anëtar
Brahim Lleshi, anëtar
Albijana Tabaku, anëtare
Negjelka Llukij, anëtare

SHPK „Radio Televizioni- Ulqin”

Muzafer Çausiç-Drejtor
Ardita Rama, kandidate e
institucioneve publike nga
fusha e kulturës
Bilal Nikeziq, kandidat i
institucioneve të arsimit
Hajrudin Çausi, kandidat nga
fusha e sportit
Xhemal Peroviq, kandidat i
OJQ
Dragomir Rakoçeviq, kandidat
nga fusha e biznesit dhe
sipërmarrjes

SHPK „Parking Servis” Ulqin

Aleksandar Jacoviq - Drejtor
ekzekutiv





III. Mbledhjet e Kuvendit

Në mbledhjen e parë të Seancës së Parë të Rregullt e mbajtur më 27 maj, 10, 17 dhe 29 qershor 2020

- U miratua Rregullorja e punës së Kuvendit të Komunës së Ulqinit,
- U miratua Raporti i punës së kryetarit të Komunës dhe organeve të administratës lokale për vitin 2019,
- U miratua Raporti i gjendjes së rregullimit të hapsirës për vitin 2019,

- U miratua Programi i rregullimit të hapsirës për vitin 2020,

- U miratua Vendimi për dhënien e pëlqimit në Programin e punës së SH.P.K. „Ujësjellës dhe kanalizime" për vitin 2020,

- U miratua Vendimi për dhënien e pëlqimit në Programin e kryerjes së veprimtarive komunale të SH.P.K. „Veprimtaritë komunale" - Ulqin për vitin 2020,
- Është tërhequr nga rendi i ditës Raporti për realizimin e Programit vjetor të kryerjes së veprimtarisë komunale dhe pasqyrimi financiar për SH.P.K. „Veprimtaritë Komunale" - Ulqin,

- U miratua Vendimi për dhënien e pëlqimit në Programin e punës së SH.P.K. „Parking servisi " për vitin 2020,

- U miratua Vendimi për dhënien e pëlqimit në Programin e punës së SH.P.K. „ Mozhura" për vitin 2020,

- U miratua Vendimi për përcaktimin e zonave akustike në territorin e Komunës së Ulqinit,
- U miratua Vendimi për taksat komunale lokale,

- U miratua Vendimi për ndryshimet dhe plotësimet e vendimit për kushtet dhe mënyrën e emitimit të muzikës në objektet hotelerike dhe përcaktimin e rrugëve, pjesëve të rrugëve, vendbanimeve dhe lokacioneve të tjera për mbajtjen e tubimeve publike në hapësira të hapura, si dhe kohën e mbajtjes së tyre në komunën e Ulqinit,

- U miratua Vendimi për ngritjen e monumentit me ngritjen e përmendores kushtuar viktimave të terretit të vitit 1979,

- U miratua Vendimi për kushtet, mënyrën dhe formën e ndarjes së mirënjohjeve publike dhe shpërblimeve në Komunën e Ulqinit,

- U miratua Vendimi për nxjerrjen e Planit akcional për të rinj për periudhën 2020-2021.

- U miratua Vendimi për caktimin e kompensimit për shpenzimet e udhëtimit për të punësuarit në organet dhe shërbimet e administratës lokale,

- U miratua Vendimi për dhënien e pëlqimit në Vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 01-680/20-2 të datës 05.05.2020. mbi nxjerrjen e Programit të masave për përkrahjen e qytetarëve dhe ekonomisë gjatë kohës së pandemisë së virusit Korona
- U miratua Aktvendimi për pagesën e shpërblimit për punën e Komisionit për përpilimin e Propozim Rregullorës së punës së Kuvendit të Komunës së Ulqinit

- U miratua Vendimi për shkarkimin e Këshillit Drejtues të NP „Qendra për Kulturë" Ulqin,

- U miratua Vendimi për emërimin e Këshillit Drejtues të NP „Qendra për Kulturë" Ulqin,

- U miratua Aktvendimi për emërimin e anëtarit të Këshillit Programor të Transmetuesit Lokal Publik „Radio-televizioni Ulqin",

- U miratua Aktvendimi për shkarkimin e anëtarit të Bordit të drejtorëve „Vodacom" SHPK,

- U miratua Aktvendimi për emërimin e anëtarit të Bordit të drejtorëve „Vodacom" SHPK.

- U miratua Aktvendimi për ndryshimet e aktvendimit për emërimin e Komisionit Komunal Zgjedhor.

Akcente nga mbledhja

Vendimi për Zonat Akustike të qytetit solli qetësinë në Bunë dhe rregull në tërë komunën

Vendimi për zonat akustike rregullon nivelet e zhurmës në territorin e komunës dhe vendet se ku mund të mbahen manifestimet publike. Në veçanti, rajoni i Adës dhe lumit Buna janë zonë e qetë në natyrë me nivel maksimal të zhurmës 35 dB. Ky kufi nuk lejon zhurmë më të madhe se biseda normale në mes të njerëzve. Dënimet për mosrespektimin e këtyre kufizimeve sillen nga 150 euro deri në 10.000 euro.



Akcente nga mbledhja

Miratohet Rregullorja e punës së Kuvendit të Komunës së Ulqinit

Pas miratimit të Statutit të Komunës së Ulqinit, Kuvendi solli Vendimin për hartimin e Rregullores së punës së Kuvendit dhe formoi Komisionin me përbërje: **Sabri Salaj, Ilir Harasani, Besart Resulani, Naser Resulbegoviq, Reshit Cuca, Rina Kasmi** e të kryesuar nga **Luigj Shkreli**.

Komisioni mbajti disa mbledhje deri në përgatitjen e versionit final. Vërejtjet, sygjerimet dhe plotësimet e anëtarëve u bënë pjesë e draftit i cili iu dorëzua Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Këshilltarët e Kuvendit të Komunës së Ulqinit në mbledhjen e mbajtur më datë 27 maj 2020 miratuan Rregulloren e re të Punës së Kuvendit të Komunës së Ulqinit.

Rregullorja e re e Punës sjell disa risi duke përcaktuar në mënyrë koncize organizimin dhe funksionimin e Kuvendit, detyrat dhe obligimet ndërmjet pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, si dhe rrit transparencën dhe llogaridhënien ndaj qytetarëve.





Mbledhja e dytë e Seancës së Parë të Rregullt e mbajtur më 22 korrik 2020

Mbledhja e Dytë e Seancës së Parë të rregullt është shtyrë për shkak të mungesës së materialit.

Mbledhja e parë e Seancës së Dytë të Rregullt e mbajtur më 7, 9 dhe 14 dhjetor 2020

- U miratua Vendimi mbi ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të buxhetit të Komunës së Ulqinit për vitin 2020,
- U miratua Vendimi për dhënien e pëlqimit Qeverisë së Malit të Zi për sigurimin e ndërtimit dhe kryerjes së veprimtarive komunale të furnizimit publik më ujë dhe administrimin e ujërave të zeza në vendbanimin Krruç në Komunën e Ulqinit
- U miratua Llogaria përfundimtare e Buxhetit të Komunës së Ulqinit për vitin 2019,
- U miratua Vendimi për parkingjet publike në Komunën e Ulqinit,
- U miratua Vendimi për nxjerrjen e Strategjisë së zhvillimit të sportit në Komunën e Ulqinit 2020-2021,
- U miratua Aktvendimi për ndryshimet dhe plotësimet e Aktvendimit për emërimin e Këshillit për Zgjedhje dhe Emërim të Kuvendit të Komunës së Ulqinit,
- U miratua Aktvendimi për ndryshimet dhe plotësimet e Aktvendimit për emërimin e Këshillit për Statut dhe Dispozita të Kuvendit të Komunës së Ulqinit,
- U miratua Aktvendimi për ndryshimet dhe plotësimet e Aktvendimit për emërimin e Këshillit për Bashkëpunim Ndërkomunal, Ndërkombëtar dhe Bashkëpunim me Diasporën të Kuvendit të Komunës së Ulqinit,
- U miratua Aktvendimi për ndryshimet dhe plotësimet e Aktvendimit për emërimin e Këshillit për Veprimtari

Shoqërore, Parashtesa dhe Ankesa të Kuvendit të Komunës së Ulqinit.

- U miratua Aktvendimi për ndryshimet dhe plotësimet e Aktvendimit për emërimin e Këshillit për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim të Kuvendit të Komunës së Ulqinit.
- U miratua Aktvendimi për ndryshimet dhe plotësimet e Vendimit për emërimin e Këshilltarëve të cilët marrin pjesë në kurorëzim.
- Nuk është miratuar Propozim vendimi për lartësin, mënyrën e llogaritjes dhe pagesën e kontributit të antarësisë Organizatës Turistike të Ulqinit,

Në Mbledhjen e dytë e Të Seancës së Dytë të Rregullt e mbajtur më 30.12.2020

- U miratua Programi i Punës së Kuvendit të Komunës së Ulqinit,
- U miratua Vendimi për formimin e trupave punues të Kuvendit,
- U miratua Vendimi për Buxhetin e Komunës së Ulqinit për vitin 2021,
- U miratua Vendimi për dhënien e pëlqimit në vendimin për ndryshimet dhe plotësimet e vendimit për përcaktimin e çmimit të ujit dhe shfrytëzimit të rrjetit të kanalizimit,
- U miratua Vendimi për sjelljen e masave ekonomike për qiramarrësit e tokës së Komunës,
- U miratua Vendimi për emërimin e anëtarit të Bordit drejtues të SHPK „Ujësllës dhe kanalizime Ulqin”,
- U miratua Vendimi për shkarkimin e kryetarit të Bordit të drejtorëve SHPK „Veprimtaritë Komunale” Ulqin,
- U miratua Vendimi për emërimin e kryetarit të Bordit të drejtorëve SHPK „Veprimtaritë Komunale” Ulqin.

Akcente nga mbledhja

Vendimi për ujësllësin dhe kanalizimin e Krruçit

Në mbledhjen e Parë të Seancës së Dytë të Rregullt e mbajtur më 7, 9 dhe 14 dhjetor të vitit 2020, Kuvendi i Komunës së Ulqinit unanimisht nxorri vendimin me të cilin i jepet pëlqimi Qeverisë së Malit të Zi që, nëpërmjet Ujësllësit Rajonal të Bregdetit të Malit të Zi, të ndërtojë rrjetin për ujësllës dhe kanalizime në Krruç.

Prezantimin e kësaj pike, përveç kryetarit të Komunës **Loro Nrekiq** e bëri edhe drejtori i Ujësllësit Rajonal për Bregdetin e Malit të Zi **Predrag Jellushiq**.





IV. Aktivitete

VIZITË KUVENDIT TË BASHKISË SË SHKODRËS

Me datë 06.02.2020, kryetari dhe sekretari i Kuvendit bashkë me bashkëpunëtorët e tyre vizituan Këshillin Bashkiak të Shkodrës. Në këtë takim, u pritën nga kryetarja e Këshillit Bashkiak **Brisela Truma Kadija**, sekretari i Këshillit Bashkiak, kryetari i Qarkut Shkodër dhe disa këshilltarë të Kuvendit.

Edhe pse në anë të ndryshme të kufirit, ky takim ishte takimi i parë mes dy strukturave vendimarrëse lokale të këtyre dy qyteteve me lidhje të hershme historike në mes veti.



Në këtë mbledhje u diskutua për harmonizimin e agjendave të veprimtarive të këshillave vendore, organizimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike vendore mes dy qyteteve si dhe lobimin në nivel qendror për ato nisma, vendimarrja e të cilave kalon përtej kompetencave të pushtetit vendor.

PROMOVIMI I LIBRIT „NJË SHQIPTAR NË CIA” I AUTORIT BASHMIR XHEMAJ

Për nder të 12 vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, me datë 18.02.2020, Këshilli Kombëtar i Shqiptarëve në Mal të Zi dhe Kuvendi i Komunës së Ulqinit organizuan promovimin e librit „Një shqiptar në CIA” i autorit **Bashmir Xhemaj**.

Në emër të organizatorëve, fjalën hyrëse e mbajtën kryetari i Kuvendit **Dr. Ilir Çapuni** dhe Kryetari i Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve në Mal të Zi z. **Faik Nika**. Për librin folën ambasadori i Republikës së Kosovës në Mal të Zi z. **Ylber Hysa** dhe analisti **Adri Nurellari**.


Libri i kushtohet Destan Berishës, një të riu nga komuna e Prizrenit, idealizmi dhe dashuria e të cilit për atheun e çuan atë në burgje, syrgjynim e deri në Amerikë ku edhe filloi të bashkëpunojë me këtë agjenci shtetërore kundër veprimtarisë komuniste në Shqipëri.





Ambasadori i Republikës së Gjermanisë dr. Robert Veber viziton Kuvendin e Komunës së Ulqinit

Në kuadër të vizitës zyrtare, më datë 13.03.2020. Kuvendin e Komunës së Ulqinit e vizitoi ambasadori i Republikës së Gjermanisë Sh. T. z. **Robert Veber**. Përveç kryetarit dhe sekretarit të Kuvendit z. **Ilir Çapuni** e **Ardit Ceka** në pritje morrën pjesë edhe përfaqësuesit e klubeve të këshilltarëve në Kuvendin e Komunës: **Sabri Salaj**, **Xhavid Hoxhiq**, **Haxhi Sulejmani**, **Bojan Gjakonoviq**, **Jasmina Hasa**, **Omer Bajraktari** dhe **Naser Resulbegoviq**.



Në fjalën hyrëse, nikoqiri e falenderoi ambasadorin për vizitën e dytë zyrtare që po i bën Kuvendit. E njoftoi gjithashtu me përbërjen e Kuvendit dhe aktivitetet e këtij institucioni, ndër të cilat veçoi fillimin e bashkëpunimit me Kuvendin e Bashkisë së Shkodrës dhe me vizitën e paralajmëruar të kryetarit të Komunës Bingen të Gjermanisë.

Ambasadori ka treguar interesim të veçantë për mbrojtjen e kripores dhe potencoi që pas votimit të Vendimit për Mbrojtje në Kuvend vijon një punë dhe veprimtari e madhe për të cilën duhet një bashkëpunim i gjërë në mes të administratës dhe në të cilën kriporja duhet të shikohet si një pjesë e një hapësire të gjërë në të cilën bën pjesë lumi Buna, Ada, Liqeni i Shasit dhe Valdanosi.

Përfaqësuesit e klubeve më tej e kanë njoftuar mysafirin për problemin e Valdanosit, për pengesat në zhvillimin e komunës, me lidhjet tradicionale të Ulqinit me Gjermaninë dhe me propozimin që ambasadori Gjerman të shpallet qytetar nderi i Ulqinit.

Festa ndryshe e Ditës së Ulqinit në vitin 2020



Të shtunën e parë të prillit, më 4 prill 2020 u shënuar Dita e Ulqinit në Sallën e Madhe të Kuvendit. Mbledhja u mbajt në rrethin më të ngushtë të udhëheqsisë në kushte jo të zakonshme për shkak të pandemisë.

Kjo mbledhje, që zakonisht është mbledhje solemne e Kuvendit, kësaj rradhe ishte mbledhje e ngushtë e Kolegjiumit dhe kryetarit të Komunës me bashkëpunëtor.

Kryetari Kuvendit në fjalimin e vet drejtuar qytetarëve u ka dërguar urimet më të sinqerta duke thënë se simbolika e kësaj dite mbetet e njëjtë prandaj edhe në këto kushte duhet të jemi optimistë për të ardhmen.



Afër qytetarëve në nevojë në kushte pandemie

Pandemia në secilën familje ka sjellë vështirësi nga më të ndryshmet. Shoqatat bamirëse nga Ulqini dhe Komuna gjatë kësaj kohe i kanë ndenjur qytetarëve pranë me ndihma.

Shoqata Bamirëse „Jetimat e Ballkanit“ e kryesuar nga **Halil Kastrati** i dha një dorë dy komunave shqiptare në Mal të Zi, asaj të Ulqinit dhe Tuzit duke i ndarë secilës paketa me ushqime dhe mjete higjienike.



Se bamirësia nuk njih kufi e ka dëshmuar edhe Fondacioni „Fundjava ndryshe“ nga Tirana e udhëhequr nga **Arbër Hajdari**. Kjo organizatë, më 23 prill 2020, dy komunave shqiptare në Mal të Zi, Ulqinit dhe Tuzit i ndau nga 100 paketa ushqimore.

Logjistikën e shpërndarjes dhe ndihmave gjatë pandemisë e ka koordinuar nënkryetarja e Komunës zj. **Hadixhe Gjoni**, e në këto aksione kanë marrë pjesë vullnetarët nga Ulqini dhe Ana e Malit, zjarrëfikësat e Ulqinit dhe Kryqi i Kuq.

Falendërim filantropistit dhe donatorit nga Tivari Hajriz Brçvak

Me datë 29 maj në ambientet e Olive garden në Ullishtë në Ulqin, u mbajt mbrëmje miqësore me humanistin e madhë **Hajriz Brçvak** i cili, me donacionet e veta, ka treguar që Ulqinin e ka për zemër, në kohë të mira dhe në kohë të vështira. Për këtë, në emër të Kuvendit të Komunës së Ulqinit **Dr. Ilir Çapuni** për kujdesin e veçantë të Brçvakut atij i dha një fletëfalenderim.

„Në thelb, në këtëj njeriu nuk i kemi borxh asgjë. Në falenderojmë Zotin që na ka bërë të jetojmë në afërsi të këtij njeriu zemërgjërë e vepërmirë dhe që këtij njeriu i ka dhënë forcë e begati. Kjo na bën neve më të sigurtë dhe falenderues.“ -- tha Çapuni me rastin e ndarjes së fletëfalenderimit.





Nënkryetari i Qeverisë së Malit të Zi Dritan Abazović, ministrat Spajiq dhe Mitroviq vizituan Ulqinin

Me datë 17.12.2020 u mbajt takimi me nënkryetarin e Qeverisë së Malit të Zi z. **Dritan Abazović**, ministrin e financave **Milojko Spajiq** dhe ministrin e

ekologjisë dhe rregullimit hapsinor **Ratko Mitroviq**. Në këtë takim u diskutua për proceset administrative për kthimin e ullishtës në Valdanos

pronarëve dhe për propozimin e ligjit për kthim që është në procedurë në Kuvendin e Malit të Zi. Kryetari i Kuvendit të Komunës Dr. **Ilir Çapuni** i tregoi që Valdanosi është çerdhe e sëmundjeve të ullirit sepse kjo ullishtë nuk mirëmbahet 42 vjet dhe se tani janë ditët më të mira që pronarët të fillojnë pastrimin e ullishtës.



Temat e tjera që u shtjelluan ishin: planet arkitektonike në parcelat e Komunës në Kala, propozimi që Kriporja është vendi i përshtatshëm për të hapur një muze shkence me pavijonet për ornitologji, kristalografi, energji ere e dielli, seizmologji dhe planetarium si dhe rregullimi i lundrimit konform Ligjit për Sigurinë e Lundrimit.

Kryetarja e Kuvendit të Komunës së Tivarit vizitoi Kuvendin e Komunës së Ulqinit

Më 9 mars 2021, Kuvendin e Komunës së Ulqinit e vizitoi **Milena Bozhović**, kryetarja e Kuvendit të Komunës së Tivarit.

Në këtë takim, kryetaren e re të Kuvendit të Tivarit e pritën kryetari **Ilir Çapuni** dhe sekretari **Ardit Ceka**. Nikoqirët mysafires i treguan për sistemin e punës të Kuvendit dhe Shërbimit të Kuvendit, për mekanizmat e transparencës, për mënyrën e tabulimit të videove dhe audiove të seancave në Youtube, Buletin të Kuvendit etj.

Në veçanti, u lançua ideja që ajo të marrë për sipër të organizojë takime të rregullta të kryetarëve të kuvendeve të komunave bregdetare në Mal të Zi, për të shkëmbyer informata, praktika të mira dhe për të vepruar së bashku.

U zbulua Përmendorja kushtuar viktimave të termetit të vitit 1979

Më 14.01.2021 nën bedemet e Kalasë së Ulqinit u zhvillua ceremonia e zbulimit të përmendores kushtuar viktimave të termetit të vitit 1979. Ky monument u ngrit sipas vendimit të Kuvendit të Komunës së Ulqinit numër 02-92/20-14 të datës 29.06.2020, i propozuar nga kryetari i Kuvendit **Ilir Çapuni** në bazë të iniciativës së qytetarëve **Mentor Lljunji** e **Sami Flamuri**.

Të pranishëm në ceremoni ishin një numër i konsiderueshem personalitetesh nga të gjitha fushat e jetës shoqërore dhe familjarët e disa viktimave.

Përmendorja është vepër e arkitektit **Muhamed Muharremit** dhe e punuar me gurë vendi nga Tula Company. Zbulimin e kësaj përmendore e bëri SH.T. ambasadori i Kosovës në Podgoricë **Ylber Hysa** dhe Ambasadori i Kroacisë në Podgoricë **Veselko Grubshiq**.





V. Përkujtimore



Përcillet me nderime prof.dr.Simë Dobreci

Kjo përkujtimore u organizua me 20.06.2020 nga Kuvendi i Komunës së Ulqinit në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të Shqipëtarëve në Mal të Zi, Bashkimin e Krijuesve, Shoqatën „Art Club” dhe shoqatën „Iliryum” nga Tuzi.

Kjo mbledhje, e cila filloi me një minutë heshtje u drejtuar nga kryetari i Kuvendit të Komunës së Ulqinit **Ilir Çapuni**.

Për rrugëtimin e vet nga Bratica deri në majat e shkencës dhe folën Dr. **Gani Karamanaga** dhe Dr. **Nail Draga**. Në emër të Fakultetit të Mjekësisë së Universiteti të Prishtinës të pranishëmve iu drejtuar Dr. **Afërdita Daka**, kurse ne emër të Komunës, kryetari **Loro Nrekiq**.

Në këtë përkujtimore u lexua edhe përshëndetja e kryetares së Kuvendit të Kosovës zonjës **Vjollca Osmani** dhe akademikut **Emil Lafa**.

Përcillet me nderime këshilltari Dritan Alaj

Mbledhja parë e Seancës së Dytë të Rregullt të vitit 2020 që filloi më 7 dhjetor 2020 pat një fillim të veçantë, një pike e rendit të ditës kushtuar këshilltarit Dritan Alaj i cili nuk e mundi luftën me CoVID19.

Përveç këshilltarëve, të pranishëm ishin familjarët dhe miqtë e Dritanit, kryetari i UDSH-së z. Mehmet Zenka, përfaqësuesit e mediave dhe institucioneve publike.

Në emër të këshilltarëve të pranishëmve iu drejtua kryetarja e Klubit të UDSH znj. **Jasmina Hasa**, kurse ne emër të ekzekutivit kryetari **Loro Nrekiq**. Në emër të familjes, të pranishëmve iu drejtua babai i Dritanit z. **Myzafer Alaj**.

Këshilltari Dritan Alaj, luftoi me sëmundjen e CoVID19 dhe ndërroi jetë më 15 nëntor 2020 në moshën 38 vjeçare. Pas vetes la nusen dhe dy fëmijë të mitur.



Orë përkujtimore kushtuar teologut Hysejn Bisha

Me datë 24.09.2020 në sallën madhe të Kuvendit të Komunës u mbajt mbledhja komemorative me rastin e vdekjes së teologut Hysejn Bisha, të cilën e organizoi kolektivi dhe nxënësit e Gjimnazit „Drita” themelues i të cilit ishte i ndjeri. „Mbledhjet e këtij lloji organizohen për të na kujtuar neve dhe qytetarëve për

standardet e larta dhe veprimtarinë fisnike që duhet ndjekur. Emri Hysejn Bishës lidhet me disa gurë të mëdhenj institucional për Ulqinin, duke filluar me veprimtarinë e Fondacionit Nur, në ndërtimin e disa objekteve fetare e deri tek shkolla Drita”, kështu iu drejtua të pranishëmve kryetari i Kuvendit Ilir Çapuni.

Buletini i Kuvendit të Komunës së Ulqinit

Botues: Kuvendi i Komunës së Ulqinit Viti II, Nr. 2, Data: 12.03.2021

Për botuesin: Dr. Ilir Çapuni • **Përgatitën:** Ardit Ceka, Sabri Salaj, Cufo Aliq, Senada Çoboviq, Astrida Lllunji, Ilvana Dollaroviç, Gjergj Pëgjonoviç, Muhamed Ukoviç • **Përkujdesja teknike:** Ilvana Dollaroviç • **Fotografitë:** Kuvendi i Komunës së Ulqinit, Gëzim Rexha, Shaqir Çausi, Fisnik Dobreci

